



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26-55/2019 (JR)
Nr. 26-55/2019/2 regj.

Tiranë, më 04 . 03 .2026

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton të gjithë personat e interesuar, se ditën e martë, më datë **24.03.2026, ora 16:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, çështja që i përket kërkesës së paraqitur nga **z. Artan Madani**, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 12, datë 12.05.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.


Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese	Natasha Mulaj
Relatore	Albana Shtylla
Anëtare	Mimoza Tasi
Anëtar	Sokol Çomo
Anëtare	Ina Rama

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në kërkesë. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të kërkuarit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE


NATASHA MULAJ
